

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Infermier në shtëpinë tuaj" SH.P.K

Sot, më datë 10.08.2022,

Mark Destanisha, shtetas shqiptar, e ditëlindjes 02.12.1990, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 037032112 dhe Nr. Personal *J01202056S* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

Eliseo Bjeshkza, shtetas shqiptar, e ditëlindjes 15.06.1996, lindur në Durrës, mbajtës i letërnjoftimit me nr. BA8124251 dhe Nr. Personal *J60615076V* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe në përputhje me të.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqerisë është **"Infermier në shtëpinë tuaj" Sh.P.K.** Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri **"Infermier në shtëpinë tuaj"** Sh.P.K.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqerisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e "Shërbime Infermierie".

NENI 3

Emri dhe vula e Shoqerisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin **"Infermier në shtëpinë tuaj"** Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqërisë do jetë "Shërbime Infermierie".



NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodrës me adresë: Shkodër, Rruga "Jeronim De Rada", Lagjia "Vasil Shanto", Zona Kadastrale 8593, Nr. Pasurie 1/33.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **100,000** (Njëqindmijë) lekë, i ndarë në 2 kuota, me nga 1 kuotë për secilin.

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare me emrin **"Infermier në shtëpinë tuaj" Sh.P.K** zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Mark Destanisha, shtetas shqiptar, e ditëlindjes 02.12.1990, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 037032112 dhe Nr. Personal *J01202056S* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit.

Eliseo Bjeshkza, shtetas shqiptar, e ditëlindjes 15.06.1996, lindur në Durrës, mbajtës i letërnjoftimit me Nr BA8124251 dhe Nr. Personal *J60615076V* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit.

Kapitali themeltar është shlyer plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.



NENI 9

Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet për një afat 5-vjeçar, Z. **Mark Destanisha**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 02.12.1990, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 037032112 dhe Nr. Personal J01202056S.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Mark Destanisha

Mark Destanisha



Eliseo Bjeshkza

Eliseo Bjeshkza

